

gjyqi-special

SECTION


1944–1950

PERIOD

1945 - 1943

Media 1

MEDIA ITEMS #1



INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT


No transcript is available for this media.

Media 2

MEDIA ITEMS #1



MEDIA ITEMS #2



- 3 -

Në krismat e pushtave pata këndue at kangën e Hilë Mosit: "Atje n'at vend të lamun, me gjak arbororit t'fllirë"... Ket mënyrë veprimi, në mes shumë të tjerëve mund të ja u vertetohet dhe ish shoku i jem - e sot vetëm i jueji - Sejrrulla Malëshova i cili ka ndodhur në Parlament kur u ba ngjarja dhe u burgos së bashku me mua.

Mbas disa muajve burg të randë me tortura e mandej mbas gjashtë muaj lirie dhe aklamacioni nën qeverinë revolucionare të Fan Nolit, në mes qindra intelektualësh që morën rrugën e ekzilit tue hënë nga ardnja e Zogut në fuqi, natyrisht qesh edhe unë.

JETA E JEME N'EKZIL

Dhe n'ekzili, ndonse isha rare i ri e kam qënë gjithnjë i përsekutuem prej agjentave të Zogut, nuk mbeta pa veprue:

Me anën e një grupi të vogël që pata formue në Paris nën emnin: BASHKIMI I DUELMËNIS, kam luftue rrebtas tiraninë e Zogut dhe penetracionin italian në Shqipëri tue i drejtue lidhjet së Kombeve e Kancelerive memorandumë e telegrame protestimi. E kam pasë qvësh Ahmet Zogun përpara opinjonit europian e i kam luftue të gjitha lidhjet që pat ba Roma me Qeverinë e Zogut. Ket shoqni e pata formue me disa studentë, puntorë e ish-oficera të hikun dhe, aktivitetin t'em mund të m'a vertetohet të gjithë shqiptarët që janë ndodhun në Paris.

Mbas shumë veprimeve të ndryshme në fushën kombëtare, ma në fund tue pa se Itali ja dita me ditë po penetronte në Shqipëri e, tue kuptue se Shqipëria nuk mund të shpëtonte vetëm me fuqit e veta, përqafova idëën e bashkimit të popujve të ballkanit në gjinin e një Konfederate.

Një bashkim ballkanik, si tash edhe asi kone, e favorizonte Rusia Sovjetike. Por, unë, tue kuptue se, nga frika e komunizmit qdo idë që dilte nga Moskë gjente kundërshtimin e të gjithë oksidentit, kët idë të natës, mendova t'i a paraqes botës m'aspektin thjeshtësisht kombëtar e të pamvarun nga Moskë.

- Nga ana tjetër nuk mund të mohojë edhe se, unë si nacionalist, edhe vet isha e jam i parimit që idëja e një bashkimit ballkanik të dalë si një vullnet i popujve të Ballkanit tue mos u drejtue Ballkani nga asnjë fuqi e madhe.

Sikundër e kam qragë mendimin t'em dhe në fletoren "BASHKIMI I KOMBIT" me 3 dhjetor 1943, Konfederatën Ballkanike e kam anërrue dhe e kërkoi

- 4 -

në mënyrë që secili popull të rregullohet me frymen, karakteristikat dhe vlerat e veta dhe, popujt e Ballkanit, si shtete të bashkueme, në politiken rivale të fuqive të mëdha të mbeten të pa-anshëm për me e ba vendin e tyre një faktor paqeje në Europë dhe në botë. Me kët frymë e drejtim kam themeluar edhe një grup të vogël nën emnin "PARTIJA NACIONAL-BALLKANIKE SHQIPTARE", të cilin muejta me e shpallë botnisht ndër ditet e rëndit që ishte tue u largue ushtria gjermane nga Shqipëria.

Me gjithë se mendimi i jem ka qënë ky, ma vonë, tue kuptue se realizimi i shpejtë i kësaj idëje, ka nevojë për ndihmën e një shteti të madh, për të parën herë drejtova një "memorandum" presidentit Hoover tue kërkue ndihmën e Shteteve të Bashkueme t'Amerikës. Bashkë me memorandumin pata qënë edhe një filamur që pata sajuë për Konfederatën.

Ndonse mizerja e mërgimit më kish randue e turbullue tepër - pse nga mos-pasja, vujësia edhe për bukë e shpesh herë filja nën ura - po për idën e bashkimit ballkanik i kam pasë drejtue edhe një memorandum Konferencës së parë për afrimin ballkanik që u mbledh në Athinë me 1931, tue i kallxue asaj konditat mbi të cilat mund të realizohet idëja e bashkimit ballkanik. Ket memorandum e pata botue edhe në formë manifeste tue harxhue parat e qersas së hotelit dhe si konsekuencë të kësaj veprë pata mbetë dhe pa odë tue u shtrengue me rjetë prap nën ura e disa herë n'odën e ndonji shoku.

- Ju njoftoj edhe se, ndër të hikunit, jam i vetmi që s'kam pasë marrë rrogë nga ndonji shtet i huaj dhe kam jetue gjithnjë tue i lypë shokve e miqve personal. Dikuj i kam marrë parë për me hangër një copë bukë, dikuj tesha me u veshë e dikuj këpucë për me u mbathë e, ndonse kame e kamë të numurit 41, të gjitha numurat prej 39 e natë i pranonja...

Jeta e jeme në Paris ka qënë e tmerrshme. Për dhjetë vjetë rrjeshtë e kam ba vet bukën, i kam la vet enët, i kam la vet teshat e qdo natë rinja me frigë se a do të kisha për me hangër ne të nesërmen, pse shpesh herë më ka qillue me mbetë rare pa të. Dhe, kjo mizerje m'asht shkaktue jo pse edhe unë s'mund të mirrsha ndonji rrogë prej ndonji qeverije, por pse kisha vendosë me luftue fqijtë që paguejshin për arsyenat e tyre politike. Lufta e jeme kundra fqijve imperialist, ka qënë sq intransigjente sa që qeshtjen e librit të Kosovës dhe nevojën e një Konfederate ballkanike, e kam pasë qragë bashkë në Jugosllavin vet dhe si konsekuencë të këtij gjesti, autoritetet jugosllave të Sushakut më patën ekspulsue. Kjo më 1927.

Prej Jugosllaviqe shkova në Vjenë por mjerisht edhe prej andej për intrigat e konsullit të Zogut Çatin Saraçit u ekspulsova e menjherë, mbas shumë mundimesh, u nisa për në Francë ku qëndrova deri më 1939.

Ket jetë aktiviteti, persekutimi e mizerje mund të m'a vertetojnë të gjithë të hikutit si dhe studentat e puntorët shqiptarë që ndodheshin në Paris.

EDHE NJI TËJETËR VEPËR QË MË NDERON:

Tue mos gjetë asnjë mbështetje të pa komprometueshme për lëvizjen t'eme shqiptare e ballkanike grupi u shpërndaq, e, si person, inspirue me ndjenja njerzore e paqësore, tue pa padrejtësin e ruqive të mëdha imperia- liste si dhe pazotesin e lidhjes së Kombave për marrëjtjen e të drejtave të sejoilitit popull, më ra ndër mend një idë e re:

Për me i dhënë një ruqë lidhjes së kombave d;M;th, për mos me e lanë Institutin e Gjeneveës vetëm ndër duart e Fashive të Mëdha e pash të do- bienme që të gjithë popujt e vegjël të botës të lidhen në një institucion të veçantë tue u organizue ata ma parë në konfederata. Për realizimin e kësaj idëje i drejtova një memorandum qeveris holandeze tue i sugjerue asaj mendimin që ajo si një shtet i respektuem në botë të merrte inisja- tiven për realizimin e këtij projekti. Dhe kjo idë e jeme e organizimit të popujve të vegjël në një institucion të veçantë asht e njoitun prej shokve të mërgimit pse dhe këto, tue e lanë vedin keq, e kam pasë shtypë dhe shpër- nda ndër broshura. Me sa diç unë, një kopje të këtij projekti, gjindet ndër dokumentat që më kam marrë. Mbassi qeverija holandeze nuk më dha një për- gjigje të favorshme, projektin t'em për bashkimin e popujve të vegjël i a pata dërgue edhe qeveris republikane të Spanjës.

Ket mendimin t'eme për lidhjen e popujve të vegjël, në një institucion të veçantë - tue u organizue ata ma parë në konfederata të veçanta - asi koha e patën marrë me tailje, por sot kjo idë asht tue u mprojtë edhe prej personaliteteve politike përgjegjëse. Disa muez ma parë, kam këndue në një fletore ku zoti Smuts-i, president i Afrikës Jugore e mpronte me nxehësi kët mendim.

x x x

TË VIJME TASH TEK ÇESHTJA QË JU INTERESON JUVE:

Tue notue unë në Paris me këto idëna të bukura e bujare që ju qiraq,

MEDIA ITEMS #6

nji fatkeqesi kombëtare i a mërritji Atdheut t'onë: Italijsa okupo Shqipnin! Nga kjo ngjarje, si për çdo shqiptar të mirë, që një grusht i randë, e i randë fort.

Në kët kohë fatzeze për Shqipnin, agjentet italian të Paris-it, tue na premtue liri, Shqipni të madhe e ku di unë, na itonin me u këthye në Shqipni! Thirrje e tmerrshme! Na që kishim hikë, na që kishim ndejtë 15 vjet jashta Atdheut kundra një tiranije të mbrendëshme, tash na kërkonin për me i u shtroue një okupatori të huej...

Se çfarë liri e Shqipnija të madhe mund të kishim me Italin unë e kuptojsha, dhe e kuptojsha mirë. Por, tue kuptue sahe se çeshtja shqiptare nuk zgjidhej ma vetëm me opozicionin t'onë që munda të bajshim na tue mbetë jashtë, si dhe për mos me e vazhduedhe mërgimin e të mbetësna si një i huej për Shqipni - pse një kalë mund të merret ma lehtë së mbrendëshmi - pranova për me u këthye n'Atdnë.

POZITA E JEME NËN OKUPACIONIN ITALIAN

Zotniç Gjykatës, tash se kalaja mund të merret ma lehtë së mbrendësh- mi. Me kët irazë deshta me thanë, unë u këneva n'Atdhe dhe me një qellim:

Për me mundë një sundim ka rrugë të ndryshme dhe mbas mendimit t'em, kurr s'ke ruqë armësh të njahtë për me luftue, ke rrugen e adoptimit. Due me thanë: unë kam qenë i mendimit për me ritue besimin e okupatorit, me shpetue me të mirë nga thojtë e tij se sa mundet, m'u armatosë e me u organizue me mjetet e tija e ma në fund në momentin e dobët të tij me i ra kokës.

Tue pasë vendosë për me hecë kësaj rruge kam rilartue me të tue rojë e shkruedononji herë si në favor të tij.

Okupacionin e pagu t'arreyeshme që të mos luftonet per deri sa të vije momenti i volitshëm dhe për një araye tjetër: mbassi në luftën që pash, Kosova u këthye me Shqipnin, qortë edhe nën okupacionin e tanë Shqipnija, ish një dobi e madhe për avenirin e Kombit t'onë që të gjithë shqiptarët të bashkëjetojnë për një kohë nën një regjim, tue u njohtë e tue komun- kue midis tyre.

Cilën kohë kam pritë unë për me luftue me armë kundra anshikut oku- pator?

Me sa kam muezjt me gjykue unë, kjo lurtë botnore që po zhvillohet, asht shkaktue e vazhdon të banet vetëm e vetëm për interesat politike e ekonomike të ruqive të mëdha, dhe, tue qenë kështu, popujt e vegjël s'kan

MEDIA ITEMS #7

- 7 -

aspak interesë me u ba me njenën apo me tjetrën anë.

Mbas mendimit t'em, popujt e vegjëli, zanin e tyne duhet t'a qesin ve-
nëm në mbarimin e lurtës d.m.th. kur fuqit e mëdha të lodhen nga lurta e ty-
ne të entrohen në tavolinën e paqës.

Shpesh herë i kam pasë thanë shokve e miqvetitë rrija të urtë që të
mund t'i pregaditemi së nesërme, pse sot që po vriten miliona e miliona
njerëz nga të gjitha anët e botës, sikur njiqind mij shqiptarë me derdhë
gjakun e tyne kundra okupacionit asht sikur me njëdhë një kovë ujë n'Oqea-
nin Atchantik - kurse nesër kur të ket pushue lurta me u vra edhe njiqind
shqiptarë për të drejtat t'ona, kishim me tërënjë vërejtjen dhe aprovimin e
të gjithë botës së qytetnurve në faviorin t'onë. Kam pasë thanë edhe: asht e
vërtetë se lurta po bahet për interesat politike e ekonomike, por nesër,
nuk mund të bahet një paqe pa marrë parasysh edhe vullnetin e popujve që
asht për drejtësi.

NJI TENTATIVË PËR TË CILËN MERITOJ LAVDATA

Pasa erdha prej egzili, tue konstatue se rreziku ma i madh që mund
të na vinte prej Itallis ishte kolonizimi i Shqipnis, i kam drejtue Qeveris
nji kërkesë tue qfaqë nevojën e krijimit të nji drejtorije për organizi-
min e shqiptarve të jashtëm. N'at kërkesë i gjithë qellimi i jem ka qenë:
në vend të ~~keqes~~ ^{Kelime} Italljan që mendonj se do të vinin, t'instationeshin
shqiptarët e jashtëm. Por, njerëzit, me gjithë lajkat që bana nuk pata suk-
ses në këtë tentativë. Këqjen e kësaj kërkesë e keni ndër dokumentat që më
keni marrë.

Edhe nji tentativë tjetër:

Mbassi nuk më doli organizimi i shqiptarve të jashtëm, e tue pa se
ajo "Partija Fashiste Shqiptare" drejtue prej Giovanni Giro-s po na e
xhveshte djelmënin nga idénat shqiptare, kërkoja formimin e nji partije të
ré nacionale nën emnin "ROJA KOMBETARE".

Me këtë tentativë - natyrisht tue mos i u largue parimeve fashiste
e tue u angazhue me luftue doktrinën komuniste - kërkoja me ruejtë indi-
vidualitetin shqiptar tue i hjekë të gjitha amblemat dhe gjuhen italljane
nga perdorimi, pse siç e dini, n'at kohë nji shumicë e madhe e popullit u
shkrue në Partin Fashiste dhe deri ndër shkolla e formacione djelmëni
kishin fillue me u ~~shkru~~ dhanë komandat në gjuhen itallisht.

Tue konstatue edhe se, nji ditë do të përlesheshim me Italljanët e tue

MEDIA ITEMS #8

- 8 -

pa se ushtria shqiptare bani fuzion me ate t'Itallis, pata kërkuë dhe formi-
min e nji Milicije shqiptare të formueme e të komandueme krejtësisht prej
shqiptarve tue caktue detyren e sajë për me ruejtë kufijt e Shqipnis.

Kët partil "ROJA KOMBETARE" mendonja me e këtye ma vonë në nji lrymë ~~ok-~~
ballkanike ashtu si e qpalia me hikjen e gjermanve: Partija NACIONAL-BALLKA-
NIKE Shqiptare - programin e së cilës beso j se e keni lexue.

Kërkesën për me formue këtë Partil i a pata paraqitë inspektorit të
Partis Giovanni Giro-s, por ~~mëkërkimi~~ m'a refuzoi tue i konsiderue idët e
mija separatiste.

I zemruem me Giovanni Giro-n për mos përkrahjen e kësaj kërkesë, pata
tentue - po për këtë qellim - edhe me pas-ardhësin e tij Piero Farinin. Kë-
tij i pata ba edhe nji telegram urimi kur u ba inspektor i partis. Teksti i
këtij telegrami që asht botue në fletoren "FASHISTI" e tregon qellimin t'em.

Në projektin t'em, edhe me Farinin e pata sukses dhe që prej asaj kohe
kam qindruë larg partis fashiste. Me gjithse tri herë rrjeshtë me shkrua më
ka thirrë partija për me u betue si antar, unë nuk jam paraqitë. Këta doku-
menta mund t'i gjeni ndër letrat që m'i keni marrë.

KË QENË FASHIST


Ndonse unë s'e kam vu asnjherë distintiven fashiste dhe kam reuzue
për me u betue në parti, shum kusht, tue mos i kuptue idët e mija të vërteta,
më kanë mbajtë për fashist. Por, në realitet, kjo s'asht e vërtetë. Idët e mi-
ja politike janë për demokraci, pse çmoj thellësisht dobin e liris së men-
meve. Vetëm, për Shqipni, tue pa se edhe populli i jonë asht nën influencën
patriarkale, feudale e fetare, kam mendue që prej kohe organizimin e intelligj-
ncës shqiptare për me i imponue vendit nocionin e shtetit e me aprojtë me
erikacitet të drejtat e popullit.

Përsëris, e kuptoi pa drejtësin e qenjëse së nji partije të vetme, por,
në nji vend si ky i jonë, ku mungojnë edhe udhat, urat e buka e gojës së shu-
micës së popullit, shum partina bajnë vetëm rjalë e dame. Veçanrisht, kur nji
popull asht mbura edhe në pikëpamjen kulturele, veprimet e shum partinave
politike e hutojnë tue i a prishë karakterin e moralin e tij. Me rjalë të
tjera unë kam qenë e jam me mendimet e Nacional Çlirimtarës.


JË ANTIKOMUNIST

Edhe kjo s'asht e vërtetë. Komunist nuk jam, por dhe antikomunist je;
dhe prova asht se, tue pasë mundësinë, unë kurr nuk e kam dantue ose përbuzë

MEDIA ITEMS #9



MEDIA ITEMS #10



MEDIA ITEMS #11

shkue në Kosovë tue hjekë njimij mundime për mbledhjen e ngarkimin e groshës ndër vagona.

Në doni me dijtë edhe personat me të cilët e kam ba punën e nda fitimin e lejes, që po ja u tregoj fitimin e 750 Kv. i a kam dhanë tregtarit Fjetër Fletullit për me m'a drejtue tregtin përgjithësisht pse unë nuk marrë vesht nga tregëtija; fitimin e 500 Kv. i a kam dhanë një tregtari italian Pasquale Casero për me më ndihmue që Roma mos të më qitë pengime mbassi siç e thash, Ministrija e Ekonomis Italjane donte që prodhimet t'ona të qonashin vetëm n'Itali mbassi ajo na i sillte sendet e tjera në Shqipni. Fjetarët e tjerë janë tregtarët: Filip Korra, Hamdi Fundo, Petraq Kastro dhe Zelo Kondili të cilët kanë derdhë kapitalet për blenjen e groshës dhe shpenzimet e transportit dhe t'importit të mallit.

Kët lejen e groshës pra e kam fitue me të vertetë me munde e me mjeshtri sa që të gjithë janë quditë për suksesin që pata. Përdorimi i kësaj leje ka qenë kaq i vështirë sa që kur deshta njëherë t'i a shes tregtarit Jonuz Shijakut nuk m'oiroj ma tepër se (1000) napoljona mbassi paraqitë një mund e një rrezik të madh në transporte.

Tash më dhet të ju njoftojë edhe se pjesën e fitimit t'em nuk e kam pasë vetëm për vëdi. Kam pasë e kam mbi supa plot njerëz për të mbajtë. Kam një ndjerkë plakë, kam dy nipa e një mesë për të martue, kam një motër me katër fëmij të cilën burri i saj nuk e shikon; kam për të mbajtë gruen t'eme me dy fëmij që më ka mbetë në Paris; tue pasë trikë partizanet e Zogut m'asht dashtë me mbajtë gjithnjë katër pesë veta t'armatosun; tue qenë unë në kat me shum akroballeqe e miqësina m'asht dashtë me çue vazhdimisht ushqime e shtrësa. Shtëpia e jeme në kat ka pritë e përcjellë edhe partizan.

Me gjithë këto obligime familjare s'kam lanë dhe shokë, miqë e akaraba pa ndihmue. Dikuej ma shum e dikuej ma pak të gjithve u kam ardhë në ndihmë. E pse kam veprue në ket mënyrë s'kam muejtë me ba as një shtëpi të vogël për venten t'eme për me muejt me prue gruen me fëmij.

Kam edhe ma për të tregue: tue qenë se unë nuk jam njeri i dhanun mbas paras e jam mësue gjithnjë me përqarue ideale, deklaroi se të tana shpenzimet që janë ba veprimet e grupit të Partis NACIONAL-BALLKANIKE shqiptare i kam ba unë vetë me fondet e mija.

x x x

MEDIA ITEMS #12

POZITA E JEME NËN OKUPACIONIN GJERMAN

Ndonse ushtria gjermane për veprimet e kohës së fundit m'asht ndye keqas, tue dashtë me rolë të drejten, unë Gjermanin nuk e kam pa me sy okupatori. Mbas mendimit t'em ajo kish ardhë në Shqipni vetëm e vetëm për arsyena strategjike dhe do të largohet posa që të mbaronte lufta. Pëhoj edhe se, ndonse në mëshërësin e shpirtit t'em nuk më ka pëlqye kurr që një popull të sundojë mbi të tjerë, kam pasë urue fitimin e gjermanis, për sigurimin e arënit të Shqipnis. Me fitimin e gjermanis kam qenë i sigurt për një Shqipni të lirë e të pa-coptueme, kurse me fitimin e Aleatve, jo.

Dhe ket besim nuk dhet të m'a queni për faj.

Siç e thash, unë s'kam besim se shtetet e mëdhaja po lutojnë për parime demokratike e drejtësi, e mandej s'kam kalue ende 30 vjetë që në konferencat e Londrës e të Versailles-s, ku Aleatet, për interesat e tyre hegjemonike e sakatuen Shqipnin në mënyrën ma të pa drejtë.

Kështu pra tue e pa Gjermanin me sy të mirë, kam rolë e shkruie në favor dhe, në periudhen e saj në Shqipni kam pasë pranue me u zgjedhë deputet. Por, prap puna e jeme s'ka qenë tjetër veçse me intervenue pranë autoriteteve shqiptare e gjermane për njeinin e tjetrit. Në mes kaq vetave që kam muejt me shpërue edhe mue më detyrohet faja e përgjithëshme që u ba ~~shpërue~~ ~~shpërue~~ ku u liruen qindra të burgosun të Nacional Çlirimtarës.

PSE PRANOVA BARRËN E KOMISARIT TË NALTË TË FUQIVE T'ARMATOSUNA

Më duket se asht e pa vend të gjykoem unë për kët çështje. Kur hynë në Tiranë fuqit e Nacional Çlirimtarës, mue më gjeten si kryetar të një grupi politik që ka marrim me Nacional Çlirimtaren e jo Komisar të Naltë të Fuqive t'Armatosuna. Si Komisar unë nuk qindrova as një javë për me zhvillue ndonji aktivitet. Me gjithë këtë, që po spjegohem edhe për pranimin e kësaj detyre:

Zotni Gjykatës, tri qelime më bënë që të pranojsh detyrën e Komisarit të Naltë dhe këto janë:

1) Tue pa se qeverija e Ibrahim Biçakut ishte tepër e butë me i u imponue Gjermanvet për me i ndalue ata për me ndërky ndër çështjet t'ona, mendova se tue u vu unë "gjermanofil" në krye të fuqive t'armatosuna do të muejsh me e shpëtue vendin nga damet e ndryshme. Tue u bazue mbi neutralitetin e shtetit t'onë të cilin e kishte njohtë Berlini, kam pasë

MEDIA ITEMS #13

- 14 -

mendue me ndalues arrestimet e gestapos, me rikthye në Tiranë t'interneimit e
Prishtinës si edhe me marrë disa masa që me hikjen e gjermanvet mos të di-
gjej qyteti e mos të na prisheshin urrat. Ket që them munda të vertetohet
prej urdhnit me shkrim që i kam dhanë komandantit të mbrojtjes kombëtare
Gjeneralit Mirdas. Letren mund t'a gjeni në Komandë e me sa mendoj mend
përmban tekstualisht këtë: "Indipendence dhe neutraliteti i shtetit shqip-
tar dita me ditë po violohet. Ushtria gjermane ka filluar me kontrollime antë-
pija e me kap njerëz. Nuk asht çudi që ma vonë të kapen e të pushkatohen njer-
rëz me shumicë si edhe të shorim djegëzjen e qytetit. Për me ndalues pra këto
dunet t'organizojmë sa ma parë një ruqi për me e marrë na vet rojen e qy-
tetit. Dhe për deri sa të mërrijmë me pasë ruqin e duhur, urdhnojmë që të gjithë
oficerat dhe nënoficerat t'inkusdrohet e të grupohen në një kazernë..."

2) Tue mendue se me hikjen e gjermanëve, partit politike, Nacional Çli-
rimtarja, Balli e Legaliteti do të përlesheshin njena me tjetren për posedi-
min e ruqit, me ruqit qeveritare kam pasë mendue me evitue një vilë-vrasje
tue i detyrue partit për me i u shtrire zgjedhjeve të një asambleje të re
ku të gjithë populli të zgjidhte regjimin që don.

3) Tue pa se të tri partit paraqiteshin forca t'armatosuna desha me
përfitue edhe unë nga pozita e jeme për me armatosë disa elementa që mund
të lidheshin me grupin t'iem politik. Partija Nacional-Balkanike Shqiptare.
Për ket qellim të tretë, që që armatimi i vullnetarve që do të rekruteja
për partin t'eme, kisha vendosë edhe një qoftë se s'do të muejuna me luejt
rolin qeveritar tue i u imponue partive që t'i u shtriheshin një zgjedhje të
rregullt, do të hidhesha edhe unë me ruqit e grupit t'iem me partin që kisha
ma afirim. Me kohën e pakët, që kisha përpap meje, shpresën ma të madhe e pata
vu në realizimin e kësaj pikë së rëndit, por dhe kjo s'më doli mbassi Mendit
Bej Frashëri i shtranguem prej grupit zogist me detyroj me dhanë dorëheqjen.

Më duhet të ju them edhe se, partija me të cilën mendoja unë me u lidhë,
ishte Nacional Çlirimtarja dhe kjo provohet me letren që i kam drejtue Gje-
neralit Dali Ndreu, në të cilën i thonja: Unë kryesoj një grup të vogël nën
emrin Partija Nacional Balkanike Shqiptare me programin që po ju dergoj.
Tue mos dashtë me ba çeshtje të përbashkët me Legalitetin e me Ballin që
asht lidhë me te, unë, po mbetem këtu. Letrën e pata çue me anën e partizanit
Khemal Meçe dhe tue mos marrë ndonji përgjigje kështu largue nga Tirana për

MEDIA ITEMS #14

- 15 -

nja dy javë deri sa u qetësue gjendja. Shenoj edhe se kur e pata dergue këtë
letër, ruqit e Ballit nuk qenë shkatërrue ende as në Durrës, as në Shkodër.

Tash, Zotni Gjykatës, në qoftë se do të qmoni shpirtin e qellimit e mi-
ja e faktin se efektivisht s'kam sjellë kurrnj dam vendit e levizjës s'uej,
unë jam i sigurt se mue do të më nxierin krejt të parajshëm. Por, prap vetëm
fakti në vetvendi që unë po të gjykoem përpara jush më randon përsëtepërm.
Unë djalë populli e natyrë luftarake, me qellimet që kam pasë s'kam qenë për
me mërrijtë këtu. Unë që edhe kur isha fëmij jam përpjekë e sakrifikue për një
ideal kombëtar e antifeudal tue pësue disa burgime, internime, ekspulsime,
tortura e që kam pa edhe mbarimin tragjik të familjës s'ime, unë nuk duhesha
të gjykoheja para jush, Nacional Çlirimtarë, pse në mëshertësin e zemrës s'emë
më pëlqen dhe aprovoj që okupatori dunet luftue me çdo kusht.

(Bekir Walter)

Bekir Walter

5 - A - 1995

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.